



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**Nr. i Dokumentit: 24.34.1-2017-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMISIONIT**  
**RREGULLATIV TË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN E**  
**PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

**Prishtinë, maj 2018**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Liridona Berisha-Kelmendi (Udhëheqëse ekipi) dhe Laureta Matoshi-Pozhegu, Mjellma Dibra-Morina, Mimoza Morina-Kelani (Anëtarë të ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Ramadan Gashi.

---

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	9
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	14
5 Qeverisja e mirë.....	15
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	17
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraparak dhe vitet e mëhershme .....	20
Shtojca III: Letërkonfirmimi .....	24

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 23/02/2018.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik..

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


#### **Opinion i pamodifikuar**

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

## Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



## Përgjigja e Kryetarit

Kryetari i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

## Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP-së) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

#### Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV**

Zyrtari kryesor financiar është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i KRPP-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.



---

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

KRPP-së i kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe nr. 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Pasqyrat Nëntëmujore me kohë;
- Planin e Prokurimit për vitin 2017; dhe
- PVF janë përgatitur me kohë dhe nënshkruar nga ZKA dhe ZKF.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

### **DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHEMNTI I KRPP-së**

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në MF, është e saktë dhe e drejtë, për shkak se gjatë auditimit nuk janë identifikuar gabime materiale.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

# 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

## Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

## Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

KRPP në përgjithësi ka kontrolle të duhura në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera, megjithatë, nevojiten përmirësime në paga dhe shtesa si dhe në menaxhimin e pasurive.

### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar <sup>1</sup>	Buxheti Final <sup>2</sup>	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>430,053</b>	<b>509,208</b>	<b>415,219</b>	<b>662,289</b>	<b>580,898</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	430,053	509,208	415,219	299,490	289,085
Huamarrja	-	-	-	361,339	258,233
Donacionet e jashtme	-	-	-	1,460	33,580

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 79,155€. Kjo është rezultat i rritjes së grantit qeveritar për investimet kapitale (61,155€) dhe mallra e shërbimet (18,000€) pas rishikimit buxhetor me vendim të Qeverisë.

Në vitin 2017, KRPP ka shpenzuar 415,219€ apo 82% të buxhetit, me një zvogëlim prej 9% krahasuar me vitin 2016. Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>430,053</b>	<b>509,208</b>	<b>415,219</b>	<b>662,289</b>	<b>580,898</b>
Pagat dhe Mëditjet	307,800	307,800	247,005	228,386	219,162
Mallrat dhe Shërbimet	117,253	135,253	104,791	431,223	255,359
Shërbimet komunale	5,000	5,000	2,351	2,680	2,279
Investimet Kapitale	-	61,155	61,072	-	104,098

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

<sup>1</sup> Buxheti Fillestar-sipas ligjit të buxhetit nr 05/L-125 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

<sup>2</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

- Kategoria e pagave dhe mëditje nuk kishte ndryshime në mes të buxhetit fillestar dhe atij final. Teprica e mjeteve financiare në fund të vitit (60,796€), ishte si pasojë që katër pozita kishin mbetur të pa plotësuar me staf të rregullte gjatë gjithë vitit 2017. Realizimi i buxhetit final për këtë kategori ishte 80%;
- Me rishikim të buxhetit, kategoria e mallrave dhe shërbimeve ishte rritur për 18,000€ me vendime të qeverisë. Edhe për kundër rritjes së buxhetit për këtë kategori niveli i realizimit të buxhetit mbetet në nivel jo të mirë (77%) e buxhetit final, kjo kishte ndodhur si rezultat i mos realizimit të kontratës për mirëmbajtjen e e-prokurimit elektronik;
- Në kategorinë e shërbimeve komunale realizimi i buxhetit final ishte 47%. Teprica e mjeteve financiare të kursyera në fund të vitit ishte (2,649€) në raport me buxhetin final, kjo ka ndodhur pasi që MAP-i i ka mbuluar shpenzimet komunale; dhe
- Buxheti final të investimet kapitale ishte në vlerë prej 61,155€, dhe ishte realizuar në tërësi. Këto mjete ishin për vazhdimin e projektit e-pasurisë.

## 3.2 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave (payrollit) që menaxhohet nga MAP dhe MF. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave janë listat e pagave të nënshkruara nga udhëheqësit e njësive organizative. Ne testuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e pagave (punëtorët aktual, rekrutimet, largimet, pushimet e lehonave dhe pensionet). Po ashtu, kemi rishikuar nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës.

### Çështja 1 - Rekrutimet jo në përputhje me rregullat në fuqi

<b>E gjetura</b>	Neni 6 i rregullorës së punës së KRPP-së, përcakton se të gjithë të punësuarit në KRPP janë shërbyes civil, duke përjashtuar anëtarët e Bordit.  KRPP kishte zhvilluar procedura të rekrutimit në bazë të LSHC për ekspert të TI-së për administrimin e platformës së prokurimit elektronik, dhe se katër herë ishte anuluar konkursi për zgjedhjen e stafit. Ne identifikuam se KRPP-ja për stafin e njëjtë bazuar në ligjin e punës kishte lidhur kontrata pune me dy punonjës për pozitat, njëri Specialist i lartë i Teknologjisë Informativë dhe tjetri Ekspert i lartë i TI-së.
<b>Rreziku</b>	Rekrutimi i stafit jo në përputhje me rregulloren e brendshme të KRPP-së dhe LSHC, rrit rrezikun që të mos përfillen kërkesat rregullative dhe të vazhdohet me rekrutime jashtë kategorisë së parapara të të punësuarëve në këtë organizatë.
<b>Rekomandimi 1</b>	Kryetari i KRPP-së duhet të sigurojë se të gjitha rekrutimet bëhen në përputhje me LSHC dhe rregulloren e punës së KRPP-së.

### 3.3 Menaxhimi i personelit

Numri i aprovuar i të punësuarave në KRPP ishte 39 pozita, ndërsa numri aktual i të punësuarve në fund të vitit ishte 37 punonjës. Ne kemi testuar menaxhimin e dosjeve të personelit dhe listat e pagave si dhe kemi krahasuar të dhënat e prezantuara nga Thesari, SIMFK dhe prezantimin e tyre në PFV. Nga testimet e bëra është verifikuar se të gjitha ndryshimet e ndodhura janë bërë në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Për mostrat tona nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

#### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

### 3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe shërbimet komunale në vitin 2017 ishte 140,253€. Prej tyre ishin shpenzuar 107,142€ apo 76%, krahasuar me vitin paraprak (2016) kemi një ulje të realizimit për 10%. Këto shpenzime kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, shpenzimet e shërbimeve të shtypjes jo marketingut, si dhe shpenzimet tjera administrative.

KRPP kishte nënshkruar 14 kontratat për shërbime dhe furnizime gjatë vitit 2017. Procedurat e prokurimit për KRPP-në kanë kaluar në përgjegjësinë e Agjencisë Qendrore të Prokurimit<sup>3</sup>.

#### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

### 3.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 61,155€, i cili ishte shpenzuar 61,072€ apo 99.86%. Shpenzimet kishin të bëjnë për sistemin e e-prokurimit. Për mostrat e testuara nuk kemi ndonjë çështje për t'u raportuar.

#### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

---

<sup>3</sup> LPP Nr. 04/L-04, neni 21a, ku përcakton se për qëllime të ekonomizimit të aktiviteteve të prokurimit për Agjencitë e Pavarura të cilat i përgjigjen Kuvendit të Republikës së Kosovës që kanë më pak se 50 (pesëdhjetë) punonjës, procedurat e prokurimit i kryen AQP-ja.

### 3.6 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuria kapitale mbi 1,000€ e prezantuar në PVF ishte në vlerë 503,000€, pasuritë nën 1,000€ ishin në vlerën 69,000€, ndërsa stoqet 5,300€.

Ne testuam blerjet e vitit 2017, rregullsinë në regjistrimin e pasurisë, si dhe ekzaminimin fizik për të verifikuar ekzistencën e pasurive.

Auditimi jonë mbi menaxhimin e pasurisë identifikoi dobësitë e paraqitura më poshtë.

#### Çështja 2 – Mangësi në menaxhimin e pasurive

**E gjetura** KRPP-ja nuk kishte menaxhuar pasuritë në pajtim me kërkesat e rregullores MF nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore. Ne kemi vërejtur se sistemi e-pasuria nuk ishte funksional, për faktin se në këtë sistem nuk janë regjistruar pasuritë nën 1,000€ që KRPP i kishte blerë gjatë vitit 2017. Për më tepër pasurit e vitit 2016 nuk ishin të evidentuar me barkode, dhe se të dhënat e prezantuara në PVF janë hartuar në Excel.

Komisionet e vlerësimit dhe inventarizimit të pasurive nuk kishin finalizuar procesin me raport dhe rekomandime të qarta për KRPP. Për më tepër gjendja mbetet e njëjtë me vitin e kaluar në lidhje me sistemin e-pasurisë.

**Rreziku** Kontrolllet e dobëta në menaxhimin e pasurisë dhe mosfunksionimi i plotë i sistemit të e-pasurisë, vështirëson menaxhimin dhe kontrollin e pasurive në dispozicion, si dhe rrit rrezikun e humbjes dhe keqpërdorimit të pasurive.

**Rekomandimi 2** Kryetari i KRPP duhet t'i rishikoj kontrollat ekzistuese për të siguruar menaxhim efikas, regjistrimin, identifikimin e gjithë pasurisë me barkode, si dhe komisionet e formuara të japin rekomandime dhe raporte të qarta për pasuritë. Në këtë aspekt të ndërmerren veprime për funksionalizimin e sistemit të e-pasurisë dhe të fuqizoj kërkesat që të gjitha pasuritë nën 1,000€ të regjistrohen në këtë sistem.

### 3.7 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 1,137€. Në përgjithësi KRPP ka kontrollat efektive në menaxhimin e detyrimeve. Vlera e mbetura si obligim ishte për shkak se, pjesa më e madhe e faturave të pranuar kishin arritur në muajin dhjetor 2017. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018.

#### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

---

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016, ka rezultuar me shtatë rekomandime. KRPP kishte përgatitur një Plan Veprimi brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit të auditimit nga ZKA për PFV e vitit 2016, ku ishte paraqitet mënyra se si do t'i zbatohen rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, dy rekomandime ishin zbatuar, katër ishin në proces përderisa një nuk ishte zbatuar ende.

Për më tepër, nga viti 2015 ishin bartur nëntë rekomandime, tre rekomandim ishte zbatuar, tre ishin në proces e sipër të zbatimit dhe tre nuk ishin zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

---

### Çështja 3 - Zbatimi i rekomandimeve nga vitet paraprake

- E gjetura** Niveli aktual i trajtimit të rekomandimeve nuk është i kënaqshëm për shkak se KRPP nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të rishikuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve dhe identifikimin e shkaqeve për veprim në adresimin e tyre të plotë. Një qasje e tillë është e nevojshme për të menaxhuar përmirësim të vazhdueshëm në të gjithë organizatën.
- Rreziku** Mungesa e një monitorimi efektiv të zbatimit të rekomandimeve ka rezultuar në dobësi të vazhdueshme lidhur me pagat dhe shtesat si dhe menaxhimin e pasurive.
- Rekomandimi 3** Kryetari i KRPP-së duhet të sigurojë që plani i veprimit rishikohet dhe rifreskohet, duke analizuar shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, të përcaktojë një afat të ri kohor, si dhe mekanizma llogaridhënës ndaj të gjithë personave përgjegjës të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve. Zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet në vazhdimësi.

## 5 Qeverisja e mirë

### Hyrje

Qeverisja e mirë përfshinë parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisja e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

KRPP-ja nuk kishte hartuar regjistrin e rreziqeve me të cilën mund të ballafaqohet dhe masat që mund të ndërmirren në arritjen e objektivave të saj.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit, për të cilën KRPP-ja nuk kishte arrit t'i zbatoj të gjitha rekomandimet e viteve të kaluara. Po ashtu pyetësori i vetëvlerësimit ishte përfunduar me kohë si kërkesë ligjore të parapara me rregullat e MFK-së por se i njëjti nuk pasqyron gjendjen reale organizatës.

#### 5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Auditimi i brendshëm është segment i rëndësishëm për të siguruar menaxhmentin e lartë se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe zbatohen në mënyrën e duhur. Aty ku vërehet se kontrollet e brendshme nuk funksionojnë si duhet, auditimi i brendshëm ofron këshilla dhe rekomandime se si ato të përmirësohen.

Në bazë të UA nr.23/2009 për Themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, KRPP-ja nuk i plotëson kriteret<sup>4</sup> për themelimin e NjAB-së.

Në vitin 2017 në KRPP ishte kryer auditimi nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm (DAB) i MF-së i cili në fokus kishte të gjitha shpenzimet dhe proceset e menaxhimit financiar për përdhën nëntë mujore (Janar-Shtator) të vitit 2017. Në këtë raport ishin dhënë gjithsej dy rekomandime, një rekomandim për planifikimin e buxhetit dhe prokurimeve në mënyrë që shpenzimet të realizohen

---

<sup>4</sup> Mbi 1 milion buxhet, 50 staf të punësuar, si dhe shkallë të lartë të rrezikshmërisë.

krahas planifikimit dhe tjetëri rekomandim për shpenzimet në mallra dhe shërbime. KRPP kishte hartuar planin e veprimt për zbatimin e rekomandimeve të DAB, ku një rekomandim ishte zbatuar dhe tjetëri ishte në proces.

## 5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Procesi i raportimit të brendshëm në KRPP-së funksionon sipas zingjirit llogaridhënës dhe strukturës organizative, raportet në baza javore, mujore, tremujore dhe vjetore mbi shpenzimet dhe aktivitete tjera operative dërgohen tek Kryetari i KRPP-së.

---

### Çështja 4 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

**E gjetura** Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar ka nxjerrë në pah disa mangësi të cilat ndikojnë në zvogëlimin e efektivitetit të menaxhimit financiar në përgjithësi. Me theks të veçantë, kontrollet ishin jo efektive në paga e shtesa dhe në menaxhim të pasurive.

KRPP ende nuk kishte arritur të hartoj listën e rreziqeve të cilat mund të rrezikonin arritjen e objektivave dhe reagimet në rast të ndodhjes së tyre.

**Rreziku** Mungesa e menaxhimit efektiv të rreziqeve dhe monitorimit të objektivave mund të ndikojnë në mos-arritjen e tyre. Kjo për shkak se veprimet e nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.

**Rekomandimi 4** Kryetari i KRPP-së duhet të sigurojë hartimin e regjistrit të rreziqeve dhe të delegon përgjegjësinë e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një zyrtar përkatës i cili do të siguroj monitorim dhe raportim në baza të rregullta në këtë fushë.



## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

---

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1. Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet që mund të shpien në modifikim të opinionit apo theksim të çështjes. Është e nevojshme që të ndërmerren veprimet e duhura për t'i adresuar shkaqet e keq klasifikimit të shpenzimeve dhe mos regjistrimit të pasurive.		Nga ekzaminimet në terren ne kemi mundur të konfirmojmë regjistrimin e pasurive mbi 1000 € në SIMFK, pjesa tjetër për e-pasurinë mbetet në proces.	
2.3-Implementimi i rekomandimeve e nga viti paraprak	Kryetari duhet t'i jap prioritet implementimit të të gjitha rekomandimeve të auditimit dhe të sigurohet që plani I veprimit menaxhohet në mënyrë proaktive dhe rishikohet në baza mujore, duke vendosur afatet dhe stafin përgjegjës për secilin rekomandim.		Pjesa më e madhe e rekomandimeve ishin të pa zbatuara edhe përkundër përpjekjeve të KRPP nuk kishte ndonjë monitorim të rekomandimeve të viteve të kaluara.	
2.4- MFK	Kryetari duhet të sigurojë që është bërë plotësim real i pyetësorit dhe vlerësim i drejtë i fushave që janë pjesë e këtij pyetësori. Të jetë konsistent dhe aty ku nuk ka veprime të vlerësohet me pikët minimale. Kjo do të ndihmonte MF dhe KRPP në fokusimin e menaxhimit në pikat ku realisht ka nevojë për tu përmirësuar.		Është plotësuar nga KRPP, por se i njëjti nuk pasqyron gjendjen reale organizatës.	
2.5.1 -Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë se është përpiluar një listë e rreziqeve të mundshme, dhe se janë caktuar masat dhe personat përgjegjës për të menaxhuar këto rreziqe.			Nuk janë ndërmarrë masa.

2.5.2 –Raportimi menaxherial	Kryetari duhet të sigurojë sa më shpejtë që është e mundur se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit operativ tek menaxhmenti i lartë, i cili duhet të jetë përmbajtësor dhe i saktë. Ky raportim do të mbështeste menaxhimin efektiv të veprimtarisë.	Po, ky rekomandim është zbatuar.		
3.3 -Buxheti	Kryetari duhet të sigurojë që performance buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore, që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final. Gjithashtu të shtohet kontrolli në buxhetimin e mjeteve në kategoritë e duhura ekonomike.	Po, ky rekomandim është zbatuar.		
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit.	Kryetari duhet të sigurojë që fillimisht të bëhet një planifikim i saktë i shpenzimeve dhe të bëhen në kodet adekuate, dhe të sigurojë që asnjë shpenzim të mos bëhet pa arsyeshmërinë e duhur. Të gjitha pagesat duhet të mbështeten me dëshmi rreth pjesëmarrjes dhe mënyrës së organizimit.	Po, ky rekomandim është zbatuar.		
3.5.1 Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të shtojë kontrollet dhe të sigurojë që proceset e rekrutimit mundësojnë marrjen e kandidatit më të mirë të mundshëm dhe me profile adekuate.			Nuk janë ndërmarrë masa.

3.6 Pasuria	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha pasuritë që janë pronë e KRPP-së, të evidentohen në regjistrat e pasurisë si dhe çdo fund vit regjistri i inventarizimit të pasurisë duhet të rakordohet me regjistrin e përgjithshëm të pasurisë, njëkohësisht që sigurohet qasja në e-pasuri.			Nuk janë ndërmarrë masa.
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2. Pasqyrat financiare	Kryetari i KRPP-së duhet të sigurojë se është bërë një analizë gjithëpërfshirëse për t'i përcaktuar shkaqet që kanë ndikuar në theksimin e çështjes. Në këtë aspekt, duhet të ndërmerren veprime konkrete për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për t'i hequr gabimet në klasifikimin e shpenzimeve kapitale dhe për të siguruar saktësinë e regjistrit të pasurive kapitale.		Nga ekzaminimet në terren ne kemi mundur të konfirmojmë regjistrimin e pasurive mbi 1000 € në SIMFK, pjesa tjetër për e-pasurinë mbetet në proces.	
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Kryetari i KRPP-së duhet të rishikojë planin e veprimit, me qëllim të përcaktimit të saktë të afateve kohore dhe stafit përgjegjës për implementimin e rekomandimeve që nuk janë zbatuar. Në fokus parësor duhet të jenë rekomandimet që prekin fushat më të rëndësishme të menaxhimit financiar dhe kontrolleve.		Kishte filluar implementimi i rekomandimeve mirëpo shumica e tyre mbeten në proces.	

2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së	Kryetari i KRPP-së duhet të sigurojë se është rishikuar procesi i plotësimit të pyetësit të vet-vlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave të identifikuar me dobësi. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësit të vet-vlerësimit si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.		Është plotësuar nga KRPP, por se i njëjti nuk pasqyron gjendjen reale organizatës.	
2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryetari i KRPP-së duhet të sigurojë se është kryer një rishikim specifik për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri më 1 tetor 2017.	Po		
2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari i KRPP-së duhet të sigurojë rishikim kritik të procesit për zbatimin të rekomandimeve të dhëna nga DAB, me qëllim të rritjes së sigurisë mbi efikasitetin dhe rregullsinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin.		Edhe përkundër faktit që KRPP ishte përpjekur që të implementohen rekomandimet e DAB ato ende mbeten të pa implementueshme.	
3.1.1 Pagat dhe mëditjet	Kryetari i KRPP-së duhet të sigurojë që zyra e personelit do të aplikoj të gjitha kërkesat e rregulloreve të shërbimit civil për kompletimin e dosjeve, duke përfshirë edhe vendimet mbi përvojën e punës për gjithë stafin.	Po		
3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari i KRPP-së duhet të ndërmerr masat e duhura për të siguruar se të gjitha pasuritë e KRPP-së të raportohen në përputhje me kërkesat e dala nga rregullorja mbi menaxhimin e pasurisë, dhe të behet shpalosja e saktë e tyre në PFV.			Nuk janë ndërmarrë masa për e-pasurinë.

## Shtojca III: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Kuvendi i Kosovës/Skupstina Kosova/Assembly of Kosovo  
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik  
Regulatorna Komisija Javne Nabavke  
Public Procurement Regulatory Commission



REPUBLICA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO  
KRPP - RKJN - PPRC

Nr. 34/2018  
Dt. 17.04.2018

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2017 dhe për implementimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: 16.04.2018

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Raportit Financiar të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetari i KRPP-së:

